



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDERMARRJA KOMUNALE PLAZH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. ____ prot.

Durres më, _____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: VAJRA LUBRIFIKANT

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 496 300 (nje milion e katerqind e nentedhete e gjashtemije e treqind)leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Komunale Plazh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.(I ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit të parashikuara në piken 1, të shtojcës 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, 2021, 2022, 2023 të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet. Kjo kërkesë konsiderohet e përrmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raportin negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përrmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përrfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që

furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, **ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij.** Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Kriteri që OE duhet të disponojë Certificate ISO 9001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

Operatori ekonomik duhet të jetë i lehtësuar sipas kategorisë IV A, në përputhje me legjislacionin për lejet dhe licencat

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, dhe nenin 84 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,(i ndryshuar) nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kjo kërkesë kërkohej pasi subjektet duhet të jenë njohës dhe tregtues të këtyre produkteve.

Sasia e mallit qe kerkohet siapas tebeles se meposhtme

SASIA E MALLIT

	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Vaj hidraulik HD 68	litra	1200		
2	Vaj motorri SAE 10 W -40	litra	1200		
3	Vaj Kamio Automat ATF II , Dexron	litra	36		
4	Vaj Kamio Manuale SAE 80-W90	litra	100		
5	Grazo per pompe hidraulike	kg	15		
6	Alkol frenash	litra	36		
7	Antifriz	litra	210		
8	Uje ADB blue	litra	900		
9	Vaj motorri SAE 5 W-40	litra	100		
10	Uje per fshireset e xhamave	litra	200		
	TOTALI PA TVSH				
	TVSH				
	TOTALI ME TVSH				

LËVRIMI I MALLIT

Të gjithë artikujt do të sillen brënda **10 ditëve** nga lidhja e kontratës, në magazinën e Ndermarrjes Komunale Plazh, Lagja 13 , Rruga Dhimiter Kraja, Plazh Durres, ku do te merren ne dorezim nga komisioni per marrjen ne dorezim te mallit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Specifikimet teknike vaj Hidraulik ISO 68 , Norma : DIN 51524 PART 2 HLP ; AFNOR NFE 48-603 HL/HM ; VICKERS M-2950-S/I-286-S DENISON HF-0/HF1/HF2

Nr	Karakteristikat:	Metoda	Njesia Matese	Vlerat
1	Gradacioni			ISO 68
2	Densiteti ne 15°C	ASTM D 1298	kg/l	0.870-0.880
3	Viscosity at 40°C	ASTM D 445	CSt	64-70
4	Viskoziteti ne 100°C	ASTM D 445	CSt	8 9
5	Indeksi I viskozitetit	ASTM D 2270	-	Min 100
6	Pika e flakerimit COC	ASTM D 92	°C	Min 210
7	Pika e ngrirjes	ASTM D 97	°C	Min -26
8	Testi emulsionit	ASTM D 1401	Min	20
9	Korrozioni ne baker	ASTM D 130	-	1a

2.Specifikimet teknike vaj SAE 10W40 , Norma : API GRUPI II:LCM; SL/CF ; ACEA: E4-08/E7-08, MB 229.1 ; VW 501.01/ 505.00;MAN228.5;VOLVO VDS3

Nr	Karakteristikat:	Metoda	Njesia Matese	Vlerat
1	Klasifikimi SAE			SAE 10w40
2	Densiteti ne 15°C	NFT60101	kg/m ³	850-870
3	Viscosity at 40°C	NFT60100	CSt	85-92
4	Viskoziteti ne 100°C	NFT60100	CSt	13.5-14.5
5	Indeksi I viskozitetit	NFT 60136	-	Min 163
6	Pika e flakerimit COC	ASTM D 93	°C	Min 228
7	Pika e ngrirjes	NFT60105	°C	Min -32
8	TBN	ASTM D 2896	Mg/KOH/g	15
9	Permbajtja e hirit	ASTM D 874	(% m)	Max 1,3
10	Mbeturina mekanike	ASTM D 2273	(% m)	Jo

3.Specifikimet teknike vaj Dexron II , Norma : GM DEXRON II D, MB 236.1 , MAN 339 D,VOLVO 97335, ZF TE ML 09

Nr	Karakteristikat:	Metoda	Njesia Matese	Vlerat
1	Densiteti ne 15°C	ASTM D 1298	kg/l	0.850-0.865
2	Viscosity at 40°C	ASTM D 445	CSt	32-36.5
3	Viskoziteti ne 100°C	ASTM D 445	CSt	7-8

4	Indeksi I viskozitetit	ASTM D 2270	-	Min 165
5	Pika e flakerimit COC	ASTM D 92	°C	Min 215
6	Pika e ngrirjes	ASTM D 97	°C	Min -38
7	Ngjyra			Kuqe
8	Mbeturina mekanike	ASTM D 2273	(% m)	Jo

4.Specifikimet teknike vaj 80w90 , Norma : API GL-5

Nr	Karakteristikat:	Metoda	Njesia Matese	Vlerat
1	Klasifikimi SAE			SAE 80w90
2	Densiteti ne 15°C	ASTM D 1298	kg/l	0,883-0,895
3	Viscosity at 40°C	ASTM D 445	CSt	130-171
4	Viskoziteti ne 100°C	ASTM D 445	CSt	13,5-24
5	Indeksi I viskozitetit	ASTM D 2270	-	Min 95
6	Pika e flakerimit COC	ASTM D 92	°C	Min 210
7	Pika e ngrirjes	ASTM D 97	°C	Max -33
8	Korrozioni ne baker	ASTM D 130		Reziston
9	Mbeturina mekanike	ASTM D 2273	(% m)	Jo

5.Specifikimet teknike Graso per pompe hidraulike, Norma : DIN 51502 KP2K-20

Nr	Karakteristikat	Vlera
1	Pamja e jashtme:	Mase xhelatinoze uniforme pa kokrriza me ngjyrë të verdhë të çelët deri në kafe të hapët.
2	Tipi sapunit	Lithium
3	Kosinstenca N.L..G.I:	2
4	Penetracioni i punuar në 25°	265 -295
5	Korrozioni në pllakë bakri 100° C, %m	Reziston.
6	Temperatura e pikerenies , °C	Min 190
7	Temperatura e operimit , °C	-25 - > +160

6.Specifikimet teknike ALKOOL FRENASH , Norma : DOT-4,SAE J1703,ISO 4925

Nr	Karakteristikat	Vlera
1	Densiteti ne 15 °C ,g/cm ³	0.99-1.1
2	Viskoziteti ne 100°C , cst	1.5-2.5
3	Temperatura e vlimit , °C	Min 140
4	pH	6-8

7. Specifikimet teknike ANTIFRIZË, Norma : SAE J1034 , ASTM D3306/D4340/D4985, MB 325.0, MAN 324 NF

Nr	Karakteristikat	Vlera
1-	Densiteti ne 15 ⁰ , g/cm ³	1.12-1.16
2-	Përbajtja e etilen glikolit , %	Min 95 %
3-	Temperatura e kristalizimit, (50/50) °C	Min -38
4-	Mbeturina mekanike , %	Nuk lejohen
5-	Ph	5.8-6.8
7-	Ngjyra	Blu e tejdukshme

8.Specifikimet teknike Adblue, Norma : DIN 70070,ISO 22241

Nr	Karakteristikat	Vlera
1	Permbajtja Urese	31.8-33.2
2	Densiteti ne 20 °C	1.0870-1.0930
3	Indeksi Refektiv ne 20 °C	1.3814-1.3843

9.Specifikimet teknike vaj SAE 5W30, Norma : API GRUP III;CJ4 CG-4/CF-4/CF/SL , ACEA E6/E7 , ACEA E9=08IS2 , MB 228.31/228.51, MAN 3477/3677,IV-10LA

Nr	Karakteristikat:	Metoda	Njesia Matese	Vlerat
1	Klasifikimi SAE			SAE 5w30
2	Densiteti ne 15°C	NFT60101	kg/l	0.850-0.870
3	Viscosity at 40°C	NFT60100	CSt	65-85
4	Viskoziteti ne 100°C	NFT60100	CSt	10-13
5	Indeksi I viskozitetit	NFT60136	-	Min 150
6	Pika e flakerimit COC	ASTM D 93	°C	Min 225
7	Pika e ngrirjes	ASTM D 97	°C	Min -48
8	TBN	ASTM D 2896	Mg/KOH/g	Min 10.03
9	Permbajtja e hirit	ASTM D 874	(% m)	Max 1
10	Mbeturina mekanike	ASTM D 2273	(% m)	Jo

10.Uje per fshirese xhami

Ti rezistoje temperatures deri ne -15 grad celcius dhe te kete viskozitet rreshqitje ne xham , si dhe detergjentin pastrues.

Ambalazhimi dhe marketimi:

Ambalazhimi të bëhet në ambalazh të përshtatshëm për ruajtjen dhe transportimin e mallit. Ambalazhi të jetë metalik ose plastik me kapacitet max 5L. Te kete mbishkrime te qarta mbi ambalazh per tipin e vajit, nivelin e references si dhe menyren e perdorimit te tij ne mjete.

Per Vajrat hidraulik ambalazhi do te jete jo me i madh se 10 lt

Mënyrat për për llogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. ***Lidhur me këtë proces, grupi i punës pas përgjigjes së INSTAT -it në te cilën shprehen se nuk disponojnë listë cmimesh per “Blerje vajra lubrifikant”nepermjet e-mail zyrtar, ka argumentuar dhe dokumentuar bazuar pikes 1 germa “b” te nenit 76 te ligjit 162/2020 konkretisht:***

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punes ngritur me urdher nr 305, date 13.08.2024, miratuar nga titullari i AK, bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhenenit 36, të LPP, si dhe nenit 42 dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Afati i levrimit: 10 dite nga data e lidhjes se kontrates.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Blerina Gremi

Gabriela Agolli

Denisa Rroqja

GRUPI I SPECIFIKIME TEKNIKE

Alfred Seferi

Shefki Lleshi

Bardhyl Kokomani